



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 042

KEC

Roli i dramatizim në edukimin e fëmijërisë së hershme

Tipi i Programit:

Historiku i Programit

Duke vlerësuar rëndësinë e dramatizimit Drejtoria Komunale e Arsimit e Komunës së Prishtinës, gjatë vitit shkollor 2009/2010, në bashkëpunim me KEC mori iniciativë që të aftësojë edukatoret e institucioneve parashkollore për realizimin e dramave dhe shfaqjeve në edukimin e fëmijërisë së hershme.

Ky projekt u bazua në rëndësinë që ka dramatizimi si pjese e lojës dhe e të mësuarit tek fëmijët. Në këtë moshë loja, si pjesë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës, zhvillohet me anë të dramatizimeve të ndryshme ku ata vihen në të gjitha rolet që imagjinojnë, si dhe luan rol të madh edhe në përcjelljen e informatave dhe mesazheve të ndryshme te fëmijët.

Gjatë vitit shkollor 2009/10 u aftësuan 75 edukatore të institucioneve parashkollore publike të komunës së Prishtinës të cilët punojnë me grup moshat 3-6 vjeç. Këto edukatore janë aftësuar për realizimin e shfaqjes me të gjitha komponentat.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohuri rreth rëndësinë së dramatizimit në edukimin e fëmijërisë së hershme.
- Shkathtësi për përgatitjen e shfaqjes me të gjithë komponentët (skenar, kostumet, kukullat, rekuizitat)
- Aftësi për punë ekipore me përgjegjësi të ndara.

Përmbajtja e trajnimit

Roli i dramatizimit të fëmijët. Format e ndryshme të dramatizimit.

Leximi i librit, tregimit deri te dramatizimi.

Mesazhet të cilat mund të përcillen me dramatizim.

Skenari- çka duhet të përmbajë, përshtatja për mosha të caktuara, roli i personazheve, efektet e ndryshme.

Llojet e kukullave dhe kostumet për skenë. Përshtatja e kukullave për skena të ndryshme. Kukulla dore, kukulla të krijuara nga edukatorët, kukulla të krijuara nga fëmijët.

Kostumet. Krijimi i kostumeve sipas skenarit të përcaktuar.

Skena dhe llojet e skenave.

Pjesa praktike vazhdon me prezantimin e projekteve. Grupet e paracaktuara krijojnë skenën e vet për skenarin , kukullat apo kostumet e përgatitura.

Grupi i synuar

Ky Program u dedikohet edukatoreve të institucioneve parashkollore dhe mësueseve të shkollave fillore.

Metoda e punës për realizimin e programit

Programi i trajnimit “Roli i dramatizim në edukimin e fëmijërisë së hershme” realizohet në dy pjesë, pjesa teorike dhe praktike.

I tërë trajnimi zgjat gjithsej **48 orë**. Pjesa teorike realizohet, me anë të një trajnimi katër ditor, që përfshin gjithsej 32 orë, ndërsa pjesa praktike realizohet me anë të dy ditëve praktike në institucione parashkollore apo shkolla fillore, ku prezantohen shfaqjet e përgatitura paraprakisht që përfshin gjithsej 16 orë pune

Vlerësimi/ Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim, si dhe kryerja e detyrave që jepen gjatë seminarit.